

Titulli: **Bashkëpunimi evropian gjatë Holokaustit**

Autorë: Anduana Shahini (Shqipëri), Aleksandar Veljanoski (Maqedonia e Veriut), Vesna Rašković (Serbi)

Këshilltare historike: Laura Fontana

Këshilltare pedagogjike: Loranda Miletic

Koha e caktuar për AM: 2 orë shkollore

Treguesi i moshës dhe vendi në kurrikulë:

Vendi	Shqipëria	Maqedonia e Veriut	Serbia
Grupi i synuar/Treguesi i moshës	15-18	15-18	15-18
Vendi në kurrikulë	<p>Holokausti nuk është një temë e detyrueshme në lëndën e historisë, megjithatë, studentëve u ofrohet një modul 2-orësh (midis opsioneve të ndryshme: kryerja e një aktiviteti praktik ose e një projekti të vogël) që përqendrohet veçanërisht tek Holokausti. Në përgjithësi, temën e Holokaustit e trajtojmë në kapitullin e 5-të "Periudha e tronditjeve të mëdha, nga Lufta e Parë në Luftën e Dytë Botërore" në klasën X të gjimnazit dhe në kapitullin e 5-të "Lufta e Dytë Botërore" në klasën XI të gjimnazit. Dita e përkujtimit të Holokaustit dhe krimeve kundër njerëzimit është 27 janari, ku shkollat ftohen të organizojnë aktivitete nga Ministria e Arsimit.</p> <p>http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/08/Document.pdf</p>	<p><i>Holokausti në Luftën e Dytë Botërore dhe pasojat e tij</i> është një temë që zhvillohet në dy kurse, si pjesë e temës: Bota, Evropa dhe Gadishulli Ballkanik në Luftën e Dytë Botërore, në klasën e nëntë në shkollën fillore.</p> <p>Më tej, kjo temë trajtohet në vitin e tretë të gjimnazit në kuadër të temës: Bota në luftën e dytë botërore - Pasojat e Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit. Gjithashtu, edhe në vitin e parë e arsimit të mesëm, në orën e parë të Historisë si lëndë me zgjedhje në 4 vjet - Gjyqet e Nurembergut.</p>	<p>Holokaustit i kushtohet vëmendje e veçantë në vitet e fundit të shkollës së mesme. Studentët mund të mësojnë për gjenezën e Holokaustit edhe më herët, veçanërisht kur trajtojnë anti-judaizmin. Mësuesit janë ata që vendosin mbi numrin e orëve që do t'i kushtohen mësimit mbi Holokaustin.</p>

Synimet e Mësimit (Çfarë duam të arrijmë nëpërmjet këtij aktiviteti mësimor?):

Nxënësit zgjerojnë njohuritë e tyre dhe të kuptuarit kritik të Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit duke studiuar shembuj të ndryshëm të bashkëpunimit në Evropë gjatë epokës naziste dhe rolin e bashkëpunëtorëve në zbatimin e politikave të "Zgjidhjes Përfundimtare".

Duke analizuar lloje të ndryshme burimesh historike dhe duke përdorur strategji bashkëpunuese dhe ndërvepruese të të nxënësve, studentët do të shqyrtojnë format dhe shkallët e bashkëpunimit (kolaboracionizmit) në rastet studimore të Bullgarisë, Rumanisë dhe Italisë.

Rezultatet e Mësimit (Çfarë do të dinë nxënësit, dhe çfarë do të jenë në gjendje të bëjnë pasi të marrin pjesë në këtë aktivitet mësimor?)

Nxënësit do të jenë në gjendje të:

1. Përkufizojnë termat e rinj: kolaboracioni, bashkëpunimi, Protokoli i Wannsee, “Zgjidhja Përfundimtare”
2. Analizojnë format e bashkëpunimit dhe kolaboracionit bazuar në shembuj të persekutimit dhe deportimit të hebrenjve në Itali, Bullgari dhe Rumani
3. Gjejnë ngjashmëritë dhe dallimet në procesin e zbatimit të “Zgjidhjes Përfundimtare”
4. Interpretojnë llojet e ndryshme të burimeve dhe dokumenteve historike.

Pyetje kyçe: Cilët kategori njerëzish u përfshinë në genocidin ndaj hebrenjve në secilin prej vendeve të analizuara?

Hyrje

Koha në dispozicion: 30 minuta

Detyrë për nxënësit: Më 1 shtator 1939 Gjermania Naziste pushtoi Poloninë. Dy ditë më vonë Britania dhe Franca i deklaruan luftë Gjermanisë. Brenda nëntë muajve pas pushtimit të Polonisë, ushtria gjermane kishte pushtuar shumicën e Evropës Perëndimore dhe Veriore. Pas agresionit ndaj BRSS në qershor 1941, Nazistët pushtuan edhe vende të tjera në Evropën Lindore.

a) Shqyrtoni [hartën 1](#) dhe [hartën 2](#), (shtojcat 1 dhe 2) dhe krahasojini, duke ju përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

1. Cili vend evropian ishte aleati i parë i Gjermanisë së Hitlerit dhe një nga themeluesit e Aleancës së Boshtit? Cilat ishin tre vendet që ishin themeluesit dhe partnerët kryesorë të asaj që u quajt më vonë Aleanca e Boshtit? Gjejini ato në hartë.
2. Cilat vende evropiane kishte pushtuar Gjermania naziste deri në fund të 1942?
3. Cilat vende u bënë aleate të Gjermanisë apo ishin shtete shumë të varura prej saj në 1942?

b) Shikoni [hartën 3](#) (shtojca 3) që tregon shpërndarjen e popullsisë hebreje në Evropë në 1933 dhe përgjigjuni pyetjes:

1. Ku jetonin komunitetet më të mëdha hebreje në Evropën para luftës?
2. Gjeni në hartë tre vendet me popullsinë më të madhe hebreje përpara L2B.

Shënim për mësuesit: Mësuesi u shpjegon nxënësve se në Evropën Lindore, veçanërisht në Poloni dhe Rusi, shumë hebrenj jetonin në qytete të vogla tregu ose fshatra që quheshin *shtetls* në gjuhën jidish ("qytete të vogla"). Hebrejtë e Evropës Lindore jetonin një jetë të ndarë, si pakicë brenda kulturës së shumicës. Ata flisnin jidish, gjuhë e cila është një ndërthurje e elementeve të gjermanishtes dhe hebraishtes. Shumica e hebrenjve perëndimorë zakonisht prireshin të merrnin zakonet e vendit në të cilin jetonin, duke u asimiluar më shpejt. Ata gjithashtu dobësuan gradualisht lidhjet e tyre me fenë. Megjithatë, përtej dallimeve të tyre sociale, kulturore dhe ekonomike, hebrenjtë u persekutuan në të njëjtën mënyrë pasi konsideroheshin si një popull i vetëm, një racë e vetme nënjerëzore e cila duhej izoluar dhe eliminuar sepse nazizmi i konsideronte të rrezikshëm. Me ardhjen e Hitlerit në pushtet në 1933, antisemitizmi mori rol kryesor në programin politik të partisë naziste, me masa të shumta diskriminuese dhe miratimin në shtator 1935 të ligjeve raciste (Ligjet e Nurembergut). Të gjithë hebrenjtë që jetonin në Gjermani u bënë armiq dhe si pasojë viktima të mundshme, dhe jeta e tyre ndryshoi përgjithmonë.

c) Në vitin 1933 nazistët erdhën në pushtet duke premtuar se do të ndërtonin një Gjermani më të madhe dhe më të fortë, të bazuar në një komunitet me lidhje racore dhe biologjike. Për nazistët, ky Rajh i Tretë do të ishte një komunitet kombëtar, popullor, një shoqëri e organizuar rreth ideve të "racës". Nazistët nuk besonin se hebrenjtë (ndër të tjerë) mund ose duhej të ishin pjesë e kësaj Gjermanie të re. Për të krijuar një Rajh të Tretë, nazistët fillimisht duhej të gjenin një mënyrë për të eliminuar gjysmë milioni hebrenj gjermanë. Me masa të ndryshme anti-hebreje, nazistët arritën të detyronin gjysmën e hebrenjve gjermanë të emigronin deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Pas Anschluss (aneksimit) të Austrisë dhe shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore, miliona hebrenj ranë nën kontrollin nazist. Pas gjashtë vitesh masash anti-hebreje, në Rajhun e Tretë kishte më shumë hebrenj se më parë. Me agresionin kundër Polonisë, në dy vitet e para të luftës filloi një fazë e re e dhunës, e cila ishte më e përhapur, sistematike dhe radikale. Në një moment në muajt e fundit të vitit 1941, u vendos që "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje" duhet të merrte fund.

Pastaj mësuesi i pyet nxënësit:

- A e gjeni dot çfarë ishte "Zgjidhja Përfundimtare"?

Mësuesi/ja i udhëzon nxënësit të studiojnë përkufizimin që shohin në ekranin e kompjuterit. Nëse nxënësit nuk janë të njohur me termin eufemizëm, ata duhet të udhëzohen të gjejnë një shpjegim në Listën e Termave Kyçe. E njëjta listë përmban edhe një shpjegim të termit "Zgjidhja përfundimtare".

"Zgjidhja përfundimtare", një version i shkurtuar i termit nazist "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje", ishte një eufemizëm i përdorur nga udhëheqësit e Gjermanisë naziste për t'iu referuar vrasjes masive të hebrenjve evropianë. "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje" ishte faza e fundit e Holokaustit dhe u zhvillua nga vera/vjeshta 1941 deri në 1945. Ishte vrasja masive, e qëllimshme dhe e planifikuar, e hebrenjve të Evropës. Shumë hebrenj u vranë përpara se të fillonte "Zgjidhja përfundimtare". Megjithatë, shumica dërrmuese e hebrenjve që vdiqën në Holokaust u vranë si pjesë e "Zgjidhjes Përfundimtare".

Mësuesi u shpjegon nxënësve se në të gjitha vendet e pushtuara evropiane ose në vendet aleate me Gjermaninë, forcat pushtuese naziste diskriminonin dhe persekutonin hebrenjtë, shpesh në bashkëpunim me autoritetet vendase. Megjithatë, përndjekja dhe dëbimi u zhvilluan në periudha të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme në secilin vend. Vrasja masive e hebrenjve nga Gjermania naziste dhe bashkëpunëtorët e saj kërkonte koordinimin dhe bashkëpunimin e agjencive qeveritare në të gjithë Evropën e kontrolluar nga Boshti. Ne nuk e dimë datën e saktë kur regjimi nazist mori vendimin për gjenocid, sepse nuk janë gjetur dokumente të sakta, por historianët besojnë se ky vendim është marrë nga Hitleri dhe udhëheqësit më të lartë nazistë në fund të vitit 1941.

Më 20 janar 1942, 15 zyrtarë të lartë nazistë dhe përfaqësues të autoriteteve të Rajhut morën pjesë në një takim të mbajtur në Wannsee (një periferi e Berlinit) të kryesuar nga Reinhard Heydrich, Shefi i Zyrës Qendrore të Sigurisë së Rajhut (ZQSR) për të diskutuar dhe bashkërenduar zbatimin e të ashtuquajturës "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje", emri i koduar për asgjësimin sistematik të hebrenjve evropianë. Adolf Eichmann, kreu i Departamentit për Çështjet Hebreje, përgatiti shënimet e takimit bazuar në një transkript të bërë nga një stenograf. Më vonë ai tregoi se fjalët që përdori për të shkruar shënimet nuk ishin fjalët ekzakte të përdorura nga pjesëmarrësit. Synimi i vërtetë i kryerjes së një gjenocidi në fakt fshihej pas gjuhës zyrtare (për shembull: 'Evakuim' nënkuptonte deportim në qendrat e përqendrimit dhe vrasjeve, dhe 'trajtimi i duhur' do të thoshte 'vrasje'. Ata folën "me terma tërëz" dhe jo me "përtypje fjalësh", ndryshe nga Eichmann, i cili u mbështet në eufemizmat në Protokoll.

Fati i miliona hebrenjve u vulos në një takim që zgjati më pak se një orë e gjysëm.

Detyra për nxënësit:

1. Lexoni tekstin me të zezë këtu poshtë, të marrë nga Protokollin e Wannsee dhe përpikuni tu jepni përgjigje këtyre pyetjeve:
 - Cili ishte qëllimi i Konferencës së Wannsee?
 - Kushtojini vëmendje fjalorit dhe shprehjeve që përdoren për t'iu referuar "çështjes hebreje". Eufemizmat, fjalët ose shprehjet e buta ose indirekte që zëvendësojnë ato që konsiderohen si shumë të ashpra ose të prera, mund të fshehin sjellje të rrezikshme ose të paligjshme. Çfarë shprehjesh përdorën nazistët për të maskuar qëllimet apo politikatat e tyre? Nënvizojini ato në tekst.

Në rrjedhën e kësaj zgjidhjeje përfundimtare të Problemit Hebre Evropian, janë përfshirë rreth 11 milionë hebrenj. . . .

Nën drejtimin e duhur, hebrenjtë tani, në kuadër të Zgjidhjes Përfundimtare, duhet të sillen në Lindje në një mënyrë të përshtatshme për t'u përdorur si krah pune. Në grupe të mëdha pune, pasi bëhet ndarja sipas gjinisë, në këto zona sillen hebrenjtë e aftë për punë dhe punësohen në ndërtimin e rrugëve, detyrë gjatë së cilës padyshim një pjesë e madhe e tyre do të bjerë për shkaqe natyrore.

Pjesa që në fund është e aftë t'i mbijetojë të gjithë kësaj – meqë kjo do të jetë padyshim pjesa me rezistencën më të madhe – duhet të trajtohet si duhet, pasi këta njerëz, të cilët përfaqësojnë një përzgjedhje natyrore, duhet të shihen si qeliza bërthamë e zhvillimit të ri hebre. (shih përvojën që na jep historia). Në programin e ekzekutimit praktik të Zgjidhjes Përfundimtare, bëhet krehja e Evropës nga Perëndimi në Lindje.

2. Përdorni këtë kod QR në celularin tuaj ose hapni [Shtojcën 6](#) dhe studioni listën e vendeve të përmendura në Protokollin e Wannsee dhe përgjigjuni pyetjeve:
 - Cilat mendoni se ishin vështirësitë kryesore të nazistëve gjatë kryerjes së genocidit nëpër të gjithë Evropën e pushtuar?
(për shembull; nazistët nuk flisnin gjuhët vendase, nuk e dinin kush ishin çifutët dhe nuk i kishin listat e tyre, dhe nuk e dinin si do të reagonte popullsia vendase....)
 - Duke pasur parasysh dëshirën e Hitlerit për të eliminuar hebrejtë në të gjithë Evropën që ishte nën sundimin nazist, çfarë ndryshimi mendoni se ka midis aleatëve dhe kolaboracionistëve? Dhe mes bashkëpunimit dhe kolaboracionit? Nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen, kontrolloni kuptimin e këtyre termave në Listën e Termave Kyç.
 - Cilat vende janë të renditura në Tabelën A? Cila është marrëdhënia mes këtyre vendeve dhe Gjermanisë Naziste? Nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen, shikoni [hartën 1](#) dhe [hartën 2](#).
 - Cilat vende janë renditur në tabelën B? Cila është marrëdhënia mes këtyre vendeve dhe Gjermanisë naziste? Nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen, shikoni [hartën 1](#) dhe [hartën 2](#).

Punë në grup.

PJESA I. Koha në dispozicion është 30 minuta

Shënim për mësuesit: Mësuesi/ja i ndan nxënësit në tre grupe. Secili grup do të marrë materiale mësimore mbi një vend që ishte aleat i Rajhut të Tretë ose bashkëpunoi me Gjermaninë naziste. Nxënësit duhet të kryejnë të gjitha detyrat e caktuara në fletë dhe të përgatisin një prezantim të përbashkët për gjetjet e tyre. Në hapin e dytë, nxënësit do të paraqesin punën e tyre dhe do të plotësojnë një tabelë të përbashkët me të dhënat për vendet e përzgjedhura - Bullgaria, Italia dhe Rumania.

Qëllimi përfundimtar është të konfirmohet teza se e ashtuquajtura «Zgjidhja përfundimtare» është një projekt nazist, por zbatimi i saj u mbështet në një gamë të gjerë kolaboracionistësh në Evropë.

Mësuesi/ja u shpjegon nxënësve se kolaboracionizmi u zhvillua në çdo vend të Evropës që ishte i pushtuar ose aleat me Gjermaninë naziste ose që ishin neutralë, por në forma shumë të ndryshme, duke filluar nga arrestimi i hebrenjve ose internimi i tyre në kampe tranziti, te konfiskimi i pasurisë së tyre ose deri në vrasje masive. Shumëllojshmëria e formave dhe shprehjeve të saj përfshinte të gjitha grupet shoqërore, partitë dhe organizatat politike, sektorët ekonomikë dhe kulturorë, kishën dhe ushtrinë së bashku me autoritetet dhe policinë.

Sjellja e secilës popullsi vendase duhet parë në raport me veprimet e qeverive të tyre. Vija mes kolaboracionizmit vullnetar dhe atij të detyruar ishte shpesh shumë e hollë. Disa njerëz u përfshinë nga nevoja, ata bashkëpunuan nga frika e dëbimit dhe hakmarrjes; të tjerët e bënë këtë për mundësitë për përparim personal, një përmirësim të kushteve të jetesës, pragmatizëm, korrupsion, përfitime personale ose bindje ideologjike. Ndërsa pati dhe nga ata që qëndruan pasivë, bënë jetën e tyre të përditshme si zakonisht, dhe kështu me indiferencën e tyre mbështetën aktivitetet kriminale në vendin e tyre. Mund të supozohet se pa ndihmën dhe nxitjen e autoriteteve vendase dhe sjelljen konformiste të popullsisë vendase, makineria pushtuese gjermane nuk mund të kishte funksionuar siç funksionoi në fund.

Grupi 1 Italia

Fuqitë e Boshtit u formuan më 27 shtator 1940, pasi Gjermania, Italia dhe Japonia u bënë aleatë me nënshkrimin e Paktit Trepalësh në Berlin. Pakti parashikonte ndihmë të ndërsjellë nëse ndonjë nga nënshkruesit pësonte një sulm nga ndonjë shtet që nuk ishte përfshirë tashmë në luftë.

Popullsia hebreje: rreth 48,000.

Hebrenjtë nën regjimin fashist në Itali

Komuniteti hebre në Itali ishte një nga më të vjetrit në Evropë. Nga vitet 1930, hebrenjtë italianë ishin integruar plotësisht në kulturën dhe shoqërinë italiane. Në vitin 1933 në Itali jetonin rreth 50,000 hebrenj. Edhe pse antisemitizmi ishte i pranishëm në diskursin politik të Musolinit dhe disa fashistëve në pushtet, edhe si një trashëgimi kulturore, ai nuk ishte një temë prioritare. Regjimi nuk shfaqti gatishmëri për të persekutuar komunitetin e vogël hebre deri në vitin 1938, kur u miratuan ligjet raciste. Politikat e Musolinit ndaj hebrenjve u konceptuan dhe u zbatuan në mënyrë të pavarur, dhe nuk ishin - siç argumentojnë ende shumë njerëz - një afrim i vonë në luftën e Hitlerit kundër hebrenjve.

Detyra për nxënësit: Shikoni ilustrimin dhe përgjigjuni pyetjeve:

1. Cilat të drejta iu privuan hebrenjve italianë që nga viti 1938?
2. Cili ishte pozicioni i hebrenjve në shoqërinë italiane pas vitit 1938?
3. Cila ishte politika e regjimit kundër hebrenjve të huaj në Itali, shumë prej të cilëve kishin ikur nga vendet e tyre për t'i shpëtuar deportimit?

Në revistën "Mbrojtja e racës" u botuan [Karikatura anti-semite](#) (Shtojca 4) me rastin e ligjit anti-semit "Masat për mbrojtjen e racës italiane". Përkthimi i fillimit të tekstit: "Në bazë të diskutimeve të Këshillit të Ministrave". Përkthimi i panelit të majtë: "Hebrenjtë nuk mund të kryejnë shërbimin ushtarak. Hebrenjtë nuk mund të ushtrojnë detyrën e kujdestarit. Hebrenjtë nuk mund të zotërojnë interesa të mbrojtjes kombëtare. Hebrenjtë nuk mund të zotërojnë toka dhe ndërtesa. Hebrenjtë nuk mund të kenë shërbëtoare ariane në familjet e tyre. Dëbimi i hebrenjve të huaj." Përkthimi i panelit të djathtë: "Nuk mund të ketë hebrenj në administratën ushtarake dhe civile. Nuk mund të ketë hebrenj në parti. Nuk mund të ketë hebrenj në organet provinciale dhe komunale. Nuk mund të ketë hebrenj në organet

parashtetërore. Nuk mund të ketë hebrenj ne banka. Nuk mund te kete hebrenj ne kompanine e sigurimeve. Hebrenjte perjashtohen nga shkolla italiane."

Midis vitit 1938 dhe shtatorit 1943, regjimi fashist diskriminoi komunitetin hebre në shumë mënyra dhe krijoi kampe përqendrimi për hebrenjtë e huaj dhe për ata hebrenj që akuzoheshin si rezistent dhe të rrezikshëm. Në kampet e internimit në Itali, hebrenjtë as nuk u vranë dhe as nuk iu nënshtruan punës së detyruar, shkalla e vdekshmërisë nuk arriti kurrë në nivelet e kampeve të përqendrimit nazist, por hebrenjtë e burgosur vuajtën nga uria, të ftohtët, sëmundjet dhe ju hoq liria. Presioni i vazhdueshëm psikologjik dhe ekonomik pas vitit 1938 ndikoi në emigrimin e shumë hebrenjve në SHBA.

Në vitin 1940 Italia hyri në luftë në anën e Gjermanisë dhe filloi fushatat e saj ekspansioniste. Që në vitin 1942 Musolini u informua për dëbimet e hebrenjve në të gjitha vendet e pushtuara nga nazistët dhe për vrasjet masive, megjithatë, ai tregoi se nuk dëshironte t'ia dorëzonte Hitlerit hebrenjtë që kishin ikur në territoret e administruara nga Italia. Ai e bëri këtë jo për keqardhje apo bujari, por për të mbajtur kontrollin mbi territoret dhe popullsinë e tij. Ushtria italiane dhe autoritetet civile i mbronin hebrenjtë në zona të tilla si Franca jugore, Greqia dhe Kroacia.

- Shikoni [dëshminë me video](#) (Shtojca 5) në të cilën Flori (Florica) Jagoda përshkruan si ka kërkuar strehim në Itali. Gjeni përgjigjet e këtyre pyetjeve:

Ku gjeti strehim familja e Florit, kur iku nga Zagrebi?

Si e përshkruan Flori atmosferën në Bari?

Cili ishte problemi më i madh për të kur mbërriti në Bari?

Situata ndryshoi në mënyrë drastike pas rënies së Musolinit (25 korrik 1943) dhe veçanërisht menjëherë pas 8 shtatorit 1943, kur u bë publike se qeveria italiane kishte nënshkruar një armëpushim pa kushte me Aleatët. Hitleri reagoi menjëherë duke pushtuar Italinë veriore dhe qendrore, si dhe duke pushtuar zonat italiane në Jugosllavi, Greqi dhe Francë. Hidhni një sy [hartës 4](#) (shtojca 7) dhe gjeni ato zona.

Me pushtimin gjerman, gjendja e hebrenjve, tashmë plotësisht të izoluar dhe të privuar nga të drejtat e tyre, u përkeqësua ndjeshëm dhe i ekspozoi ata ndaj rrezikut të dëbimit. Ndryshe nga vendet e tjera, hebrenjtë në Itali jetonin të përhapur në të gjithë gadishullin dhe vetëm në qytetet më të mëdha kishte komunitete hebreje. Për nazistët ishte me rëndësi thelbësore të ishin në gjendje t'i lokalizonin, edhe sepse shumë hebrenj jetonin të fshehur ose përdornin një identitet të rremë. Pikërisht për shkak se regjimi fashist kishte bërë tashmë një regjistrim të hebrenjve në vitet e mëparshme, autoritetet naziste ishin lehtësisht në gjendje të merrnin listat e personave që do të arrestoheshin të cilët ishin regjistruar si hebrenj.

2. Pushtimi i Italisë nga Gjermania, kampet dhe deportimi i hebrenjve.

Pushtimi gjerman i Italisë e ndryshoi rrënjësisht situatën për 43,000 hebrenjtë e mbetur italianë që jetonin në gjysmën veriore të vendit. Gjermanët krijuan shpejt një aparat SS dhe policie dhe rivendosën qeverinë fashiste në formën e një qeverie kukull (RSI, Republika Sociale

Italiane, e udhëhequr nga Musolini) për të mundësuar arrestimet dhe dëbimet. Me ndihmën e autoriteteve vendore, autoritetet gjermane mblodhën hebrenjtë në Romë, Milano, Xhenova, Firenze, Trieste dhe qytete të tjera të mëdha në Italinë veriore.

Për të grumbulluar hebrenjtë përpara dëbimit, nazistët krijuan kampe tranziti policor në Fossoli di Carpi pranë Modenës dhe në Borgo San Dalmazzo, afër kufirit francez. Grumbullimet nuk u zhvilluan gjithmonë sipas pritshmërive të autoriteteve naziste, sepse pas arrestimeve të para në shtator dhe tetor 1943, hebrenjtë u përpoqën me çdo kusht të arrinin në një vend të sigurt, duke lëvizur vazhdimisht nga një vend në tjetrin. Shumë emigruan në Zvicër ose u përpoqën të arratiseshin në jug, ku kishin zbritur aleatët. Për të shpëtuar veten, hebrenjtë u fshehën në manastire, spitale dhe shtëpi private, falë edhe ndihmës së shumë italianëve dhe autoriteteve fetare, jo vetëm të katolikëve.

80% e hebrenjve që jetonin në Italinë e pushtuar mundën tu shpëtojnë dëbimeve, që është përqindja më e lartë në të gjithë Evropën e pushtuar. Shumica e hebrenjve të arrestuar u denoncuan nga fashistët ose nga spiunët e punësuar nga nazistët. Pothuajse të gjithë hebrenjtë e kapur në Itali u deportuan në Aushvic-Birkenau për t'u vrarë sapo të mbërrinin, shih [hartën 5](#) (shtojca 8) me përjashtim të disa grupeve të vogla hebrenjsh me kombësi angleze ose turke që u dëbuan në kampet e përqendrimit në Bergen-Belsen, Buchenwald, Ravensbrück dhe Flossenbürg. Sipas të dhënave nga faqja e internetit e USHMM, gjermanët deportuan të paktën 8,564 hebrenj nga Italia, Franca e pushtuar nga Italia dhe ishujt e Rodos dhe KOS, shumica e tyre në Aushvic-Birkenau.

Shqyrto [grafikun kohor 1](#) (shtojca 9) dhe përgjigju pyetjeve:

1. Shqyrto [grafikun kohor 1](#) të ngjarjeve nga tetori 1943, të cilat kanë të bëjnë me fatin e hebrenjve italianë nën pushtimin gjerman. Cili ishte roli i Gjeneralit të SS Odilo Globocnik dhe kampit La Risiera di Sa Sabba afër Triestes?
2. Pse grumbullimet nuk u zhvilluan gjithmonë sipas pritshmërive të autoriteteve naziste?
3. Sa hebrenj u dëbuan nga Italia në total dhe sa hebrenj i mbijetuan Holokaustit në Itali?

Grupi 2 Bullgaria

Iu bashkua fuqive të Boshtit: 1 mars 1941

Në pranverën e vitit 1941, Bullgaria u bashkua zyrtarisht me Fuqitë e Boshtit dhe u [shpërblye](#) me pjesë të Thrakisë Greke dhe Maqedonisë Jugosllave, të cilat të dyja kishin popullsi hebreje. Edhe para fillimit të luftës, Bullgaria ishte në bashkëpunim me Gjermaninë naziste në politikën e saj.

Popullsia hebreje: 48,000 – 50,000

Shënim për nxënësit: Detyra është të studiohet teksti dhe burimet vizive të dhëna si dhe tu jepet përgjigje pyetjeve.

Për të gjitha burimet vizive përpikuni tu përgjigjeni këtyre pyetjeve:

A) Vëzhgoni dhe identifikoni: Çfarë vini re së pari? Cilët njerëz dhe objekte janë paraqitur në fotografi? Si janë renditur në kornizë? Në çfarë ambienti janë? A ka të dhëna të dukshme tekstuale (fjalë, shenja, etj.)? A ka detaje që nuk mund t'i identifikoni?

B) Reflektoni: Sipas jush, cila mund të ketë qenë arsyeja e realizimit të këtyre fotografive? Si u realizuan këto foto? Çfarë po ndodh në imazhe? Kur janë marrë? Kush ishte audienca e synuar për këto foto?

C) Pyetje të thelluara: Çfarë mungon në foto? Çfarë ndodhi vetëm disa çaste para se të shkrepej aparati? Dhe menjëherë më pas? Çfarë mendimesh apo supozimesh ju shkojnë në mend pasi shikoni këto imazhe?

Së pari, do të mësoni për atë që ndodhi në lidhje me hebrenjtë dhe antisemitizmin në Bullgari deri në vitin 1943, pastaj çfarë ndodhi që nga pranvera e vitit 1943. Ju do të shqyrtoni politikat e ndryshme ndaj hebrenjve bullgarë në vendin e vjetër dhe në territoret e reja të aneksuara. Ju duhet të kuptoni se çfarë përgjegjësish ndërmoi qeveria bullgare, qoftë duke bashkëpunuar me nazistët ose në mënyrë autonome.

- a) A kishte antisemitizëm në Bullgari para fillimit të Luftës së Dytë Botërore? Si ndryshoi jeta e hebrenjve bullgarë pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Kombit?

Deri në vjeshtën e vitit 1939, kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, në Bullgari nuk kishte antisemitizëm të përhapur dhe të ashpër. Deri në vitin 1940, qeveria pro-gjermane miratoi ligjet e para anti-hebreje, pavarësisht protestave të qytetarëve. Rregullat ligjore bullgare filluan të zbatoheshin edhe në territoret e pushtuara. Cari Boris III miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Kombit, i cili vendosi shumë kufizime ligjore për hebrenjtë: ata u përjashtuan nga shërbimi publik dhe u detyruan të mbanin Yllin e Verdhë ose [Distinktivët e Davidit](#). Për më tepër, ata u detyruan të jetonin në ambiente tmerrësisht të mbipoplluara. Përveç kësaj, hebrenjtë nuk lejoheshin të ecnin në [rrugët kryesore](#) ose të merrnin pjesë në grumbullime publike, radiot e tyre, makinat dhe sendet e tjera me vlerë u konfiskuan dhe shumica e meshkujve hebrenj të rritur u rekrutuan [për punë të detyruar](#). Pas Konferencës së Wannsee, në shtator 1942, bullgarët krijuan një Komisarariat (zyrë) për Çështjet Hebreje dhe emëruan një antisemit të njohur, Aleksandër Belev, në krye të tij. Komisarriati, i cili financohej nga paratë e marra nga llogaritë bankare të bllokuara të hebrenjve, shpejt u bë adresa kryesore e Bullgarisë që merrej me çështjet hebreje.

- b) Bullgaria zbatoi politika të ndryshme ndaj hebrenjve bullgarë në vendin e vjetër dhe në territoret e reja të aneksuara. Mendoni dhe përgjigjuni: Çfarë ndodhi me popullsinë hebreje në Sofje dhe Bullgari gjatë Luftës së Dytë Botërore? Çfarë ndodhi me popullsinë hebreje që jetonte në territoret e pushtuara (Serbia Jugore, Maqedonia dhe Trakia)? Duke marrë parasysh të gjithë informacionin e mbledhur, a mendoni se Bullgaria ishte një vend që bashkëpunoi në gjenocidin ndaj hebrenjve?

Territoret e pushtuara nga Bullgaria

Hidhini një sy [Hartës 5](#) dhe identifikoni territoret e përmendura në tekstin e mëposhtëm.

Megjithatë, autoritetet bullgare i dëbuan banorët hebrenj nga territoret greke dhe jugosllave që Bullgaria kishte pushtuar në vitin 1941. Më 22 shkurt 1943, Aleksandar Belev dhe SS Hauptschturmführer Theodor Dannecker, përfaqësuesi i Adolf Eichmann në Bullgari, nënshkruan një marrëveshje të fshehtë për deportimin e 20,000 hebrenjve nga Tokat e Reja. Meqenëse atje kishte vetëm rreth 12,000 hebrenj, 8,000 të tjerët do të mblidheshin nga Bullgaria e Vjetër, dhe të parët që do të viheshin në shënjestër ishin komunitetet në Kyustendil dhe Plovdiv. Bullgaria po përgatitej për Zgjidhjen Përfundimtare. Gjatë gjysmës së parë të marsit 1943, autoritetet ushtarake dhe policore bullgare kryen dëbimin e 11,343 hebrenjve që banonin në [territoret e pushtuara nga bullgarët](#). Pasi hebrenjtë ranë në duart e gjermanëve, autoritetet gjermane i transportuan ata në Treblinka, ku pothuajse të gjithë u vranë në dhomat e gazit ose u pushkatuan.

Bullgaria

Gjatë luftës, Bullgaria aleate e Gjermanisë nuk i dëboi hebrenjtë nga provincat kryesore të Bullgarisë. Kur lajmet për dëbimet e suksesshme dhe dëbimin e afërt të hebrenjve nga Sofja mbërritën në kryeqytet, politikanët e opozitës, intelektualët bullgarë dhe anëtarët e klerit bullgar ngritën alarmin dhe filluan të protestojnë hapur kundër dëbimit të hebrenjve nga provincat kryesore të Bullgarisë. Car Boris i ishte i prirur të vazhdonte me dëbimet derisa Dimitur Peshev, nënkryetari i Parlamentit, një përfaqësues nga Kustendili dhe një anëtar i shquar i vetë partisë në pushtet të Borisit, ndërhyri personalisht dhe e bindi Carin të vononte dëbimin e planifikuar. Më 19 mars 1943 Peshev prezantoi një rezolutë në parlament ku kritikonte dëbimet dhe kërkonte ndalimin e tyre. Shumica në parti në pushtet, padyshim me miratimin e heshtur të Borisit, votuan kundër rezolutës së Peshev dhe detyroi dorëheqjen e tij në fund të marsit. Pas dorëheqjes së Peshev, zyrtarët bullgarë rifilluan përgatitjet për të vazhduar dëbimet. Vala në rritje e protestës publike, e cila përfshiu ndërhyrjen e Mitropolitit të Kishës Ortodokse Bullgare, përfundimisht e detyroi Borisin të ndryshonte mendje dhe të anulonte dëbimet në maj 1943. Menjëherë pas kësaj, qeveria bullgare njoftoi dëbimin e 20,000 hebrenjve nga Sofja drejt provincave. (Në vitin 1934, popullsia hebreje e Sofjes ishte rreth 25,000, 9 përqind e popullsisë së përgjithshme të kryeqytetit.) Policia shtypi brutalisht protestat popullore të organizuara nga hebrenj dhe jo-hebrenj. Brenda rreth dy javësh, autoritetet bullgare dëbuan pothuajse 20,000 hebrenj, i zhvendosën në fshatrat bullgare dhe i çuan meshkujt në punë të detyruar në kampet e punës së detyruar. Autoritetet bullgare konfiskuan gjithashtu pjesën më të madhe të pasurisë së lënë pas nga të dëbuarit. Në vitin 1945, popullsia hebreje e Bullgarisë ishte ende rreth 50,000, në nivelin e saj të paraluftës.

- c) Përmes informacionit që mund të merrni nga teksti i propozuar, nga imazhet e përzgjedhura dhe nga video, përgjigjuni pyetjes:
A mori pjesë ushtria bullgare në Holokaust? Arsyetoni përgjigjen tuaj duke kërkuar për informacione përkatëse nga burimet.

Gjatë gjysmës së parë të marsit 1943, autoritetet ushtarake dhe policore bullgare kryen dëbimin e 11,343 hebrenjve që jetonin në territoret e pushtuara nga bullgarët. Autoritetet bullgare ia dorëzuan hebrenjtë e arrestuar autoriteteve gjermane që menaxhuan

transportin e dëbimit në qendrën e vrasjeve të Treblinkës (në Poloninë e pushtuar), ku pothuajse të gjithë u vranë me të mbërritur, ose në dhomat e gazit ose u qëlluan me armë zjarri.

Thrakia

[Filmi](#), Dëbimi i hebrenjve nga Trakia e pushtuar nga bullgarët.

[Foto](#) Hebrenj që po detyrohen të hipin në një anije deportimi në lumin Danub.

Maqedonia

[Foto](#) Autoritetet bullgare grumbullojnë hebrenjtë në Maqedoninë e pushtuar

[Foto](#) Hebrenj që ngarkojnë një fuçi me ujë në një tren deportimi në Shkup

[Dëshmi](#), Albert Sarfati i ka mbijetuar luftës dhe na jep dëshminë e tij:

Na ngarkuan në vagonët e bagëtive, pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë veta për vagon, përfshirë bagazhin. Nuk kishte hapësirë të mjaftueshme dhe shumë veta duhej të qëndronin në këmbë. Nuk kishte ujë. Fëmijët po qanin... Një grua në një vagon po lindte... por nuk kishte mjek. Arritëm në Shkup në mesnatë. Natë. Errësirë. Ata hapën vagonët dhe na shtynë në dy ndërtesa të mëdha në errësirë. Trenit tonë i ishin shtuar vagona me hebrenjtë nga Shtipi. Duke u penguar me njëri-tjetrin në errësirë, duke tërhequr zvarrë bagazhet tona dhe duke u rrahur vazhdimisht nga ushtarët bullgarë, fëmijët, të moshuarit dhe të pafuqishmit u përpoqën të futeshin në ndërtesë. Kur doli dielli, ne kuptuam se ishim në Shkup në ndërtesën e Monopolit dhe të gjithë hebrenjtë e Maqedonisë ishin grumbulluar po atë ditë.

[Komuniteti Hebre i Manastirit](#)

Këto portrete individuale dhe familjare të anëtarëve të komunitetit hebre të Manastirit, Maqedoni, u përdorën nga autoritetet pushtuese bullgare për të regjistruar popullsinë hebreje përpara dëbimit të saj në mars 1943.

Grupi 3 Rumania

Iu bashkua fuqive të Boshtit: 23 nëntor 1940.

Popullsia hebreje: [757,000](#) përpara Luftës së Dytë Botërore (pothuajse 4% e popullsisë)

Shënim për nxënësit: Lexojeni tekstin me kujdes dhe zgjidhni të gjitha detyrat.

Para Luftës së Parë Botërore, Rumania kishte reputacionin e të qenit, së bashku me Rusinë, vendi më antisemitik në Evropë. Megjithëse komunitetet hebreje kishin qenë të pranishme për shekuj, hebrenjtë nuk ishin plotësisht të integruar, por ishin detyruar të jetonin veçmas nga shoqëria rurale jo-hebreje. Shumica dërrmuese e hebrenjve rumunë nuk kishin as shtetësi kombëtare, ndaj nuk i gëzonin plotësisht të drejtat e tyre. Në Rumani ka patur një traditë të gjatë të antisemitizmit të përhapur, të dhunshëm dhe popullor.

Në fund të Luftës së Parë Botërore, ndonëse hebrenjtë kishin fituar të drejtën, ata nuk lejoheshin të merrnin pjesë në jetën publike dhe u diskriminuan në shumë fusha të shoqërisë, për shembull në universitete.

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, në diskursin politik kombëtar u shfaqën lëvizje gjithnjë e më ekstreme antisemite, të cilat kishin qenë evidente tashmë në vend prej disa kohësh. Pasi Gjermania e detyroi Rumaninë t'i jepte një pjesë të madhe të territorit të saj Bashkimit Sovjetik, Hungarisë dhe Bullgarisë, në shtator 1940 Marshalli Ion Antonescu erdhi në pushtet. Ai u mbështet nga lëvizja fashiste, antisemite e Gardës së Hekurt

Detyrë: Shikoni [hartën 1](#) dhe [hartën 2](#) dhe shikoni se si kufijtë e Rumanisë ndryshuan në vitin 1940.

Shënim për nxënësit: Qeveria e Marshallit Ion Antonescu shpalli shpejt një sërë masash kufizuese kundër hebrenjve të Rumanisë. Hebrenjtë iu nënshtruan persekutimeve të tilla si arrestime të rastësishme, shantazhe, tortura dhe konfiskim të pronave dhe bizneseve. Rumania mbajti anën gjermane në luftën e agresionit kundër Bashkimit Sovjetik në qershor 1941. Brenda disa ditësh nga fillimi i pushtimit, ushtarë, policë dhe civilë rumunë vranë [15,000 hebrenj në qytetin e Iasi-t](#) dhe kryen persekutim të hebrenjve në qytete të tjera nën administrimin rumun. Ushtria dhe xhandarmëria rumune, me bashkëpunimin dhe mbështetjen e pjesshme të njësisve gjermane SS dhe policisë, si dhe të disa banorëve vendas, masakruan [100,000-120,000](#) hebrenj të Besarabisë dhe Bukovinës së Veriut (zona që ishin aneksuar nga BRSS në qershor 1940 dhe u ripushtuan nga Rumania në verën e 1941).

Masakra të ngjashme u kryen nga ushtria rumune edhe në Ukrainën Perëndimore dhe veçanërisht në qytetin e Odesës. Duke autorizuar [vrasjet masive në territoret lindore](#), Marshalli Antonesku ndoqi metodën naziste të spastrimit etnik. Pas ekzekutimeve në Bukovinë dhe Besarabi, hebrenjtë e mbijetuar u dëbuan në Transnistria në vitin 1941. Transnistria ishte një zonë kryesisht e pabanuar midis lumenjve Dniester dhe Bug që Gjermania naziste ia kishte dhënë Rumanisë në këmbim të pjesëmarrjes së saj në luftën kundër Bashkimit Sovjetik

Detyrë: Shikoni [hartën 3](#). Ajo shënon territoret ku Rumania mori pjesë në masakrat e hebrenjve në vitet 1941-1942.

Shumë hebrenj vdiqën nga uria ose sëmundjet gjatë dëbimeve në Transnistria ose pas mbërritjes atje. Të tjerët u vranë nga njësitë rumune ose gjermane, ose në Transnistria ose pasi u transportuan përmes lumit Bug në Ukrainën e pushtuar nga gjermanët.

[Filmi](#) tregon një shembull se si ndodhi dëbimi.

Shënim për nxënësit: Autoritetet rumune krijuan disa geto dhe kampe vdekjeje në Transnistria. Megjithatë, pavarësisht nga këto përgatitje paraprake, hebrenjtë nga Mbretëria e Vjetër (Rumania para Luftës së Parë Botërore) dhe nga Transilvania jugore nuk u dëbuan. Lidhur me politikën antisemite të Antoneskut kundër hebrenjve rumunë, duhet nënvizuar se Antonesku konsideronte si rumunë të vërtetë vetëm hebrenjtë që jetonin në Rumaninë e para

Luftës së Parë Botërore dhe ata që jetonin në Transilvaninë jugore, ndryshe nga hebrenjtë që jetonin në Besarabia dhe Bukovina jugore. Ai urdhëroi që hebrenjtë ruralë të Besarabisë dhe Bukovinës të shfaroseshin dhe hebrenjtë e qytetit të burgoseshin në geto dhe kampe përqendrimi.

Në verën e vitit 1941 ai dëboi [150,000](#) hebrenj nga Besarabia dhe Bukovina në Transnistria, ku shumë vdiqën ose u vranë. Në pjesën tjetër të Rumanisë, hebrenjtë ishin të përqendruar në qendrat urbane dhe pronat e tyre u konfiskuan. Megjithatë, Antonesku refuzoi t'ua dorëzonte ata nazistëve.

Detyrë: 1. Bazuar tek teksti dhe tek [foto 1](#), përgjigjuni pyetjes: kush ishte përgjegjës dhe kush mori pjesë në dëbimin e hebrenjve nga Besarabia dhe Bukovina në Transnistria?

1. Shikoni [foton 2](#), përcaktoni se cilët hebrenj u dërguan në Transnistria nga një fshat i Besarabisë sipas gjinisë dhe moshës?

Nga koha e dëbimit të tyre në Transnistria deri në çlirimin e tyre nga Ushtria e Kuqe në mars 1944, [120,000](#) të dëbuar vdiqën si rezultat i vrasjeve, hipotermisë, urisë dhe epidemive. Ky numër ishte përveç dhjetëra mijëra hebrenjve vendas në Transnistria që ishin viktimat të pushtimit rumun.

Në total, në zonat e kontrolluara nga Rumanian nën diktaturën e Antonescu-t (1940-1944) u vranë [380,000 – 400,000](#) hebrenj, përfshirë hebrenjtë e Transnistrias.

Është e qartë se autoritetet rumune nuk e kryen dot plotësisht persekutimin dhe vrasjet masive të hebrenjve. Si rezultat, rreth [300,000](#) hebrenj brenda Rumanisë nuk ranë viktimë e "Zgjidhjes përfundimtare" të gjermanëve dhe i mbijetuan Holokaustit.

Përgjigjuni pyetjeve:

1. A ishte Rumania një vend anti-semit përpara Luftës së Dytë Botërore?
2. Sa hebrenj jetonin atje para luftës?
3. Cilat ishin kushtet e jetesës së hebrenjve pasi Rumania u bashkua me Fuqitë e Boshtit?
4. Cilat ishin iniciativat dhe veprimet e autoriteteve rumune kundër hebrenjve gjatë dhe pas pushtimit të Bashkimit Sovjetik?
5. Deri në çfarë shkalle e përbushi Rumania "Zgjidhjen Përfundimtare"?
6. Sa hebrenj u vranë në zonat e kontrolluara nga Rumania nën diktaturën e Antoneskut?

PJESA II. Koha në dispozicion: 20 minuta

Shënim për mësuesit: Së fundi, nxënësve u kërkohet të përmbledhin të gjitha gjetjet përmes një table pas diskutimit të ideve me klasën përmes një diskutimi të udhëhequr nga mësuesi. Pas plotësimit të tabelës, nxënësit krahasojnë të dhënat dhe gjejnë ngjashmëri dhe dallime midis formave të ndryshme të aleancës dhe kolaboracionit.

	Italia	Bullgaria	Rumania
U mund/iu bashkua forcave të Boshtit			
Popullsia hebreje përpara L2B			
Cilat kategori njerëzish u përfshinë në kryerjen e gjenocidit të hebrenjve?			
Si u zhvillua “Zgjidhja përfundimtare”?			
A kishte ndonjë specifikë në lidhje me zbatimin e “Zgjidhjes Përfundimtare”?			
Popullsia hebreje pas L2B			

PËRFUNDIMI

Koha në dispozicion: 10 minuta

Shënim për mësuesit: aktiviteti mësimor përfundon me një kartë dalje 3-2-1 si një formë e vetëvlerësimit dhe reagimit për mësuesin mbi suksesin e arritjes së rezultatit. Nxënësit e plotësojnë individualisht kartën e daljes dhe ia dorëzojnë mësuesit.



3-2-1 EXIT TICKET



3	3 facts from today's learning activity
2	2 things I found interesting
1	1 question I have for next time

Listë termash kyçe

Kolaboracioni: Kolaboracioni si pjesë e historisë së L2B, histori e profesionit dhe jetës së përditshme, dhe si një faktor thelbësor ndikues në Holokaust. Kolaboracioni shihet si një reagim ndaj ofertave dhe kërkesave (të detyruara) të bëra nga Nazistët që legjitimonte, shoqëronte, ushtronte, mbështeste dhe/ose i bënte të mundura politikat e nazistëve.

Kamp përqendrimi: Në të gjithë Evropën e pushtuar nga gjermanët, nazistët krijuan kampe për të arrestuar dhe, nëse ishte e nevojshme, për të vrarë të ashtuquajturit armiq të shtetit, ku përfshiheshin hebrenjtë, ciganët, kundërshtarët politikë dhe fetarë, anëtarët e lëvizjeve të rezistencës kombëtare, homoseksualët dhe të tjerë. Burgimi në një kamp përqendrimi ishte me kohëzgjatje të pakufizuar, nuk ishte i lidhur me një akt të caktuar dhe nuk i nënshtrohej asnjë procesi gjyqësor. Përveç kampeve të përqendrimit, regjimi nazist drejtonte disa lloje të tjera kampesh, si kampet e punës, kampet tranzite, kampet e të burgosurve të luftës dhe qendrat e vrasjeve.

Bashkëpunimi: lidhja me një tjetër apo të tjerë për përfitim të përbashkët; dmth. "Aleatët e Luftës së Dytë Botërore bashkëpunuan gjerësisht në zhvillimin dhe prodhimin e teknologjive të reja dhe ekzistuese për të mbështetur operacionet ushtarake dhe mbledhjen e inteligjencës gjatë Luftës së Dytë Botërore".

Eufemizëm: Një eufemizëm është një fjalë ose frazë në dukje jo-fyese, që përdoret për të zëvendësuar atë që do të konsiderohej fyese ose lënduese. Është një "mënyrë e sjellshme" për të thënë diçka të pakëndshme. Zyrtarët nazistë shpesh përdornin eufemizma kur flisnin për akte dhune dhe terrori dhe mbi qëllimin e tyre për të vrarë të gjithë hebrenjtë. Për shembull, shprehja "trajtim special" (Sonderbehandlung, në gjermanisht) është përdorur për t'iu referuar vrasjeve.

Fashizmi: një lëvizje politike që ngre lart kombin kolektiv, dhe shpesh racën, mbi individin dhe që mbron: një shtet totalitar të centralizuar të kryesuar nga një lider karizmatik; zgjerimin e territoreve te vendit, mundësisht me forcë ushtarake; shtypjen e dhunshme dhe nganjëherë asgjësimin fizik të kundërshtarëve të vërtetë dhe atyre të perceptuar.

"Zgjidhja përfundimtare": është një version i shkurtuar i termit nazist "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje". Ky term ishte një eufemizëm i përdorur nga udhëheqësit e Gjermanisë naziste. "Zgjidhja përfundimtare e çështjes hebreje" ishte faza e fundit e Holokaustit dhe u zhvillua nga 1941 deri në 1945. Ishte vrasja masive, e qëllimshme dhe e planifikuar e hebrenjve të Evropës. Shumë

hebrenj u vranë përpara se të fillonte "Zgjidhja përfundimtare". Megjithatë, shumica dërrmuese e hebrenjve që vdiqën në Holokaust u vranë si pjesë e "Zgjidhjes Përfundimtare".

Gjenocid: Gjenocidi i referohet shkatërrimit të koordinuar dhe të planifikuar të një grupi njerëzish (pasi ai "grup" përcaktohet nga autorët). Megjithëse gjenocidi shoqërohet pothuajse gjithmonë me vrasje masive, ky krim është një përpjekje për të shkatërruar grupin, jo domosdoshmërisht për të vrarë çdo anëtar të atij grupi. Disa e quajnë gjenocidin "krim i krimeve". Të tjerë e etiketojnë gjenocidin si krimin më të madh ndaj njerëzimit, sepse gjenocidi synon të zhdukë një pjesë të njerëzimit.

Përkufizimi i gjenocidit është dhënë në Konventën e OKB-së të vitit 1948 për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit. Sipas kësaj konvente, aktet përbëjnë gjenocid nëse ato kryhen "me qëllim për të shkatërruar, tërësisht ose pjesërisht, një grup kombëtar, etnik, racor ose fetar, si të tillë". Teksa ky është përkufizimi ligjërisht i zbatueshëm i gjenocidit, termi gjenocid i paraprin Konventës së 1948 dhe pak studiues janë plotësisht të kënaqur me këtë përkufizim, pjesërisht për shkak të vështirësive praktike në vërtetimin e "qëllimit". Për dekada të tëra studiuesit kanë paraqitur dhe debatuar një sërë përkufizimesh alternative të asaj që përbën "gjenocid", shpesh duke dashur të zgjerojnë listën e grupeve të përfshira në përkufizimin e OKB-së.

Qendrat e vrasjeve: kampe që u krijuan për vrasjen sistematike të hebrenjve dhe romëve. Stacioni i kamionëve të gazit në Kulmhof (Chelmno) dhe kampet Belzec, Sobibor dhe Treblinka i shërbenin ekskluzivisht këtij qëllimi. Auschwitz, Majdanek dhe MalyTrostinets përmbanin objekte të ngjashme me ato në kampet e vdekjes, si dhe luanin role si kampe përqendrimi, kampe pune ose kampe tranziti.

Kamp internimi: Internimi është burgosje e njerëzve, zakonisht në grupe të mëdha, pa akuza ose qëllim për të ngritur akuza. Ky term përdoret veçanërisht për izolimin "e shtetasve armiq në kohë lufte ose të të dyshuarve për terrorizëm". Kampi i internimit ndryshon nga kampi i përqendrimit, por megjithatë përmban disa elemente të tij (p.sh. kampet fashiste në pjesën lindore të Adriatikut).

Kampet e tranzitit: Kampet e tranzitit funksiononin si ambiente të përkohshme ku mbaheshin të mbyllur hebrenjtë që prisnin dëbimin. Këto kampe zakonisht ishin ndalesa e fundit përpara deportimit në një qendër vrasjesh.

SHTOJCA

1. ALEANCA E BOSHTIT, 1939-1941

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/axis-alliance-1939-1941?parent=en%2F3343>




2. ADMINISTRIMI GJERMAN I EVROPËS, 1942

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/german-administration-of-europe-1942>



3. Shpërndarja e popullsisë hebreje në Evropë, rreth vitit 1933

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/european-jewish-population-distribution-ca-1933?parent=en%2F2906>



4. [Karikaturë anti-semite](#) e publikuar në revistën fashiste *Mbrojtja e Racës*, pas hyrjes në fuqi të Ligjeve Racore (15 nëntor 1938).

https://commons.wikimedia.org/wiki/File:Difesa_della_Razza.jpg



5. Flori (Florica) Jagoda përshkruan përpjekjet për tu fshehur në Itali

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/oral-history/flory-floritza-jagoda-describes-seeking-refuge-in-italy?parent=en%2F5174>

7. Protokolli i Wannsee, 20 janar 1942

<https://avalon.law.yale.edu/imt/wannsee.asp>

Vendi	Numri
A.	
Gjermania brenda	131,800
Austria	43,700

Territoret lindore	420,000
Qeveria e përgjithshme	2,284,000
Bialistok	400,000
Protectorati i Bohemisë dhe Moravisë	74,200
Estonia	- free of Jews -
Letonia	3,500
Lituania	34,000
Belgjika	43,000
Danimarka	5,600
Franca / territoret e pushtuara	165,000
Franca / territoret e papushtuara	700,000
Greqia	69,600
Holanda	160,800
Norvegjia	1,300
B.	
Bullgaria	48,000

Anglia	330,000
Finlanda	2,300
Irlanda	4,000
Italia, përfshirë Sardenjën	58,000
Shqipëria	200
Kroacia	40,000
Portugalia	3,000
Rumania, përfshirë Besarabinë	342,000
Suedia	8,000
Zvicra	18,000
Serbia	10,000
Slllovakia	88,000
Spanja	6,000
Turqia (pjesa evropiane)	55,500
Hungaria	742,800
BRSS	5,000,000

Ukraina	2,994,684
Rusia e Bardhë, përfshirë Bjalistokun	446,484
Totali	mbi 11,000,000

7. HARTË <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/article/italy>



8. HARTË

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/deportations-from-italy-1943-1945?parent=en%2F5174>



9. GRAFIKU KOHOR I HOLOKAUSTIT 1945

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/article/1943-key-dates>

10. <https://www.yadvashem.org/holocaust/about/final-solution-beginning/romania.html>

11. <https://www.yadvashem.org/download/education/conf/Stark.pdf>

12. Rumania 1933 <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/romania-1933>



13. Rumania 1941 <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/romania-1941>



14. <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/romanian-participation-in-massacres-1941-1942>



15. VIDEO – DEPORTIMI I HEBRENJVE NGA BALTI, BESARABIA

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/film/deportation-of-jews-from-balti-bessarabia>

16. Ion Antonescu https://www.yadvashem.org/odot_pdf/Microsoft%20Word%20-%205743.pdf

17. DEPORTIMI I HEBRENJVE NGA KISHINEVI

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/photo/deportation-of-jews-from-kishinev?parent=en%2F6527>



18. HEBRENJTË E GRUMBULLUAR PËR DEPORTIM NGA NJË FSHAT NË BESARABI

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/photo/jews-assembled-for-deportation-from-a-bessarabian-village>



19. FUQITË E BOSHTIT DHE HOLOKAUSTI

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/article/axis-powers-and-the-holocaust>

20. Bullgaria https://www.yadvashem.org/odot_pdf/Microsoft%20Word%20-%206092.pdf

21. **Law for Protection of the Nation**

<https://documents.yadvashem.org/index.html?language=en&&TreeItemId=5089464>

22. BULLGARIA, NDRYSHIMET E KUFIJVE 1939-1942

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/map/bulgaria-border-changes-1939-1942>



23. DEPORTIMI I HEBRENJVE NGA THRAKIA E PUSHTUAR NGA BULLGARËT

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/film/deportation-of-jews-from-bulgarian-occupied-macedonia?parent=en%2F5955>



23. DISTINKTIVI HEBRE I DETYRUAR PËR TU MBAJTUR NË GREQI

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/photo/compulsory-jewish-badge-in-greece>

24. NORBERT J. YASHAROFF PËRSHKRUAN NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TË JETESËS PËR HEBRENJTË NË BULLGARI <https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/oral-history/norbert-j-yasharoff-describes-the-change-in-living-conditions-for-jews-in-bulgaria>

25. REGJISTRIMI PËR PUNË TË DETYRUAR NË SELANIK

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/photo/registration-for-forced-labor-in-salonika?parent=en%2F7665>



26. AUTORITETET BULLGARE GRUMBULLOJNË HEBRENJTË NË MAQEDONINË E PUSHTUAR

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/photo/bulgarian-authorities-round-up-jews-in-occupied-macedonia>



27. KOMUNITETI HEBRE I MANASTIRIT: FOTOGRAFI PËR REGJISTRIM

<https://encyclopedia.ushmm.org/content/en/gallery/jewish-community-of-monastir-photographs-for-registration?parent=en%2F9150>

28. TABELA

	Italia	Bullgaria	Rumania
U mund/ ju bashkua fuqive të Boshtit			
Popullsia hebreje përpara L2B			
Cilat kategori njerëzish u përfshinë në kryerjen e gjenocidit të hebrenjve?			
Si u zhvillua “Zgjidhja përfundimtare”?			
A kishte ndonjë specifikë në lidhje me zbatimin e “Zgjidhjes Përfundimtare”?			
Popullsia hebreje pas L2B			